



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:080566

Datë: 16.12.2024

Numri i dokumentit: 06634058

KA.nr.304/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “ADA GAS” Sh.P.K. me NUI 811184192 dhe seli në Gjilan, të cilin në bazë të prokurës e përfaqëson avokati Hamdi Jashari me seli në rrugën “Mulla Idrizi” p.nr. në Gjilan, kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës, të cilin në bazë të ligjit e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Kosovës, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 10.12.2024 në të cilën mungoi përfaqësuesi i paditësit, ndërsa me pjesëmarrje të përfaqësuesit të së paditur, më 16 dhjetor 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “ADA GAS” Sh.P.K. me NUI 811184192, kundër të paditurit Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale Inspektorati i Punës, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktit administrativ nr. 307/2020 të datës 20.05.2020 të së paditurit dhe kthimin e çështjes në rivendosje.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 06.07.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e aktit administrativ nr. 307/2020 të datës 20.05.2020 të së Paditurit dhe kthimin e çështjes në rivendosje.
2. Ai në padi ka pretenduar se i Padituri në shkallën e parë ka nxjerr vendim Nr. p.02/B-01 të datës 22.01.2020 me të cilin ka shqiptuar masën ndëshkimore në formë të gjobës në lartësi prej 6,000.00€ për shkak të mos zbatimit të dispozitave ligjore nga neni 13 par. 1 dhe 2 të Ligjit nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, ndërsa pas parashtrimit të ankesës i Padituri në shkallën e dytë ka lëshuar vendimin nr. 307/2020

të datës 20.05.2020 duke e refuzuar si të pa bazuar ankesën dhe duke e vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë.

3. Për më tepër, ai fillimisht ka deklaruar se me rastin e fillimit të punimeve në kompleksin “ADA RESIDENCE”, ka lidhur kontratën “marrëveshjen e bashkëpunimit” me “N.P.SH Mehuka”, tek i cili A.F. ka qenë i punësuar me kontratë të rregullt të punës. Në lidhje me këtë ka shtuar se, duke e pasur parasysh faktin që aksidenti në punë ka ndodhur më datë 29.10.2019 ndërsa i lënduari A.F. ka qenë duke kryer punë dhe detyra të punës në vend punishten e investitorit që nga muaji maj i vitit 2019 që do të thotë për rreth 4-5 muaj më parë dhe deri më momentin e aksidentit nuk ka pasur vërejtje ndaj investitorit qoftë nga punëdhënësi i të dëmtuarit A.F. e as nga inspektorati, i Padituri është dashur që të verifikoj faktin që i punësuar A.F., se a ka pasur ndonjë dëshmi rreth përgatitjes së tij profesionale apo ndonjë trajtim profesional për të vërtetuar faktin se i njëjti ka qenë i aftë dhe i përgatitur për detyrat e punës.
4. Përfaqësuesi me prokurë i Paditësit gjatë seancave ka deklaruar se pas konsultimeve me pronarin e paditësit, R.M., si dhe provat të cilat mi ka dorëzuar kemi konstatuar se shtëpia dhe paluajtshmëria në të cilin ka ndodhur incidenti e ku është lënduar punonjësi i ndërmarrjes Mehuka nuk kanë qenë asnjëherë në pronësi e as në asete të Paditësit, por ka qenë pronë private e R.M. i cili ka rastisur të jetë edhe pronar i Paditësit. Tutje ka sqaruar se e gjithë procedura nga i Padituri gabimisht është zhvilluar kundër Paditësit, pasi ky i fundit nuk ka far të bëjë me atë investim dhe nuk ka qenë fare përgjegjës për sigurimin eventual të kushteve të punës në vend punishte.
5. I padituri në përgjigje e tij në padi dhe gjatë gjithë procedurës si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se bazuar në raportin zyrtar të datës 03.12.2019 me nr. të referencës 01/3-221 përpiluar inspektorët e punës më datë 23.10.2019 kanë kryer vendshikimin dhe ekzaminimin e fakteve me rastin e lëndimit në punë të punësuarit A.F. gjatë montimit të llamarinës në çati të shtëpisë në një objekt në të kompleksin “ADA Residence” në fshatin Përlepnice në Gjilan, ndërsa inspektorati i punës duke u bazuar në raport nxjerr vendimin P-02/b-01 të datës 22.01.2020, përmes së cilit i shqipton gjobën në shumë prej 6,000.00 euro Paditësi për shkak të mos zbatimit të dispozitave ligjore nga neni 13 par.1 në par.1.3 nën par.1.16 neni 16 par. 1 neni 18 par1 nën par 1 neni 22 par.1 dhe2 të ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe neni 10 par.1 dhe 2 të Rregullores nr. 06/02017 për kriteret minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë në vend ndërtim e të përkohshme apo mobile.

6. Ka shtuar se, pasi Paditësi ka parashtruar ankesë kundër vendimit të organit të shkallës së parë të inspektoratit të punës, organi i shkallës së dytë në kuadër të Inspektoratit të Punës pas shqyrtimit të ankesës dhe administrimit të provave ka nxjerr vendimin e datës 307/2020 duke e refuzuar ankesën dhe e ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë të inspektoratit të punës me nr. P-02/b-01 të datës 22.01.2020.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

7. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: raporti zyrtar i inspektoratit të punës me nr. 01/6-22 i datës 03.12.2019; vendimi 02/6-01 i datës 22.01.2020 i inspektoratit të punës; vendimi IP 307/2020 i datës 20.05.2020 i inspektoratit të punës, komisioni i organit të shkallës së dytë; aktvendim me nr. të referencës 951-2643-2019 i zyrës kadastrale komunale në Gjilan; kontrata për shitblerjen e paluajtshmërisë LRP NR.504/2022 me nr.ref. 151/2022 e datës 25.01.2022 te noteri Islam Azemi në Gjilan; skica e objekteve të banimit në kompleksin “Ada Residence”; marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të Paditësit dhe “NPSH Mehuka Com” e datës 01.05.2019; u dëgjua R.B. si dhe u lexuan shkresat e lëndës administrative të dërguara nga i Padituri përmes përgjigjes në padi.
8. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
9. Inspektorët e Punës në Gjilan më 23.10.2019 ka bërë këqyrjen e vendit dhe ekzaminimin e fakteve me rastin e lëndimit në punë të punëtorit A.F. gjatë montimit të llamarinës në çati të shtëpisë në një objekt në kompleksin “ADA Residence” në fshatin Përlepnice në Gjilanit. Me këtë rast ishte konstatuar se Paditësi është investitor, ndërsa punë kryes ishte “N.P.SH Mehuka Com” dhe se punëtori A.F. ka pësuar lëndime në vendin e punës. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes raportit të inspektimit të 01/6-22 i datës 03.12.2019.
10. Inspektorati i Punës në shkallën e parë më 22.01.2020 kishte dhënë vendimin me numër të protokollit 02/6-01, me të cilin Paditësit i shqipton gjobë në shumë prej 6,000.00€, për shkak të mos zbatimit të nenit 13 para. 1 nënpara. 3 dhe nënpara. 16, neni 18 para.

1 nënpara. 1, nenit 22 para. 1 dhe 2 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur.

11. Kundër vendimit të shkallës së parë Paditësi ka ushtruar ankesë, me të cilin kishte pretenduar se ai ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me “NPSH Mehuka Com”, te i cili punëtori i lënduar ka pasur marrëdhënien e punës. Edhe në atë ankesë kishte ngritur pretendimet se i Padituri është dashur të sqaroj se punëtori i lënduar a ka pasur përgatitje profesionale, pasi aftësimi i punëtorit është detyrë e punëdhënësit të tij. Në vazhdim të ankesës i kishte ngritur të njëjtat pretendime sikur gjatë kësaj procedurës. Këto fakte gjykata i vërtetoi nga ankesa e Paditësit.
12. I Padituri me vendimin nr. 307/2020 të datës 20.05.2020 e ka refuzuar si të pa bazuar dhe e ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur.
13. Gjykata gjithashtu konstatoi se punëtorit i lënduar në momentin e aksidentit në vendin e punës kishte marrëdhënie pune me NPSH Mehuka Com e seli në Gjilan. Këtë fakt gjykata e konstatoi në bazë të kontratës së penës me kohë të caktuar, të lidhur më 28.05.2019 ndërmjet punëtorit të lënduar A.F. dhe NPSH Mehuka Com.
14. Gjykata gjithashtu gjeti se Paditësi ishte investitor në kompleksin “Ada Residence”, i cili në atë kohë ishte në ndërtim në fshatin Perlepnice të Gjilanit, ndërsa NPSH Mehuka Com ishte punë kryesi i kontraktuar. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur më 01.05.2019 ndërmjet Paditësit dhe NPSH Mehuka Com, përmes të cilës ky i fundit sipas nenit 3 të asaj marrëveshjeje e ka pasur për detyrë që të “... kryej shërbime për nevojat e Nptsh Autorgeni Ada Gash Company shpk në lëmin e ndërtimitarisë, (Sistemi I ujëmbledhësive në çartit e shtëpive te kompleksi Ada Rezidence-Perlepnice)”. Gjithashtu, me të njëjtën marrëveshje ishte paraparë se NPSH Mehuka Com do të paguhej në baza komerciale sipas marrëveshjes për punët e kryera, si dhe shërbimet t’i kryej me kohë dhe me kualitet sipas dinamikës së kërkuar nga Paditësi. Përveç kësaj, me asnjë dispozitë të asaj marrëveshjeje nuk ishte paraparë përgjegjësia në rast të aksidentit në punë.
15. Gjykata e mori parasysh edhe deklaratën e R.M., aksionarit të vetëm dhe personit të autorizuar të regjistruar në ARBK të Paditësit, megjithatë gjeti se ajo nuk është e besueshme në lidhje me faktin se kush ka qenë investitor në kompleksin Ada Residence. Gjykata sqaron se ai gjatë deklaratës së tij lidhur me natyrën e bashkëpunimit me NPSH

Mehuka Com kishte pohuar se në rastin konkret marrëveshjen e ka lidhur si person fizik. Gjithashtu ka shtuar se marrëveshja ka qenë verbale dhe se përgjegjësinë e ka pasur punë kryesi, ndërsa pretendimi në ankesën se ka pasur marrëveshje me shkrim me NPSH Mehuka Com është bërë nga avokati i tij në bërë në bazë të shkresave. Duke qenë se në shkresat e lëndës gjendet marrëveshja e bashkëpunimit, në të cilën qartazi shihet Paditësi e kishte kontraktuar NPSH Mehuka Com për rregullimin e ujëmbledhësve në çatitë e shtëpive në Ada Residence, si dhe duke u bazuar në pohimet e Paditësit në ankesën ndaj vendimit të shkallës së parë dhe në padinë lëndore se ka pasur marrëveshje me shkrim me NPSH Mehuka Com, gjykata i vlerësoj deklaratimet e R.M. nuk përkojnë me provat tjera në shkresat e lëndës, rrjedhimisht nuk janë të besueshme.

16. Nga provat tjera të administruara gjykata vërtetoi edhe faktet se R.M. ishte pronar i palujtshmërive në Ada Residence, megjithatë ato nuk ishin relevante për këtë gjykatë, meqenëse në çështjen konkrete vendimtare ka qenë fakti se kusht ishte investitor i shtëpive e jo e pronari i palujtshmërive, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

III. Vlerësimi meritor i rastit

17. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e pabazuar në ligj, rrjedhimisht ajo duhet të refuzohet.
18. Në rend të parë, gjykata gjen se procedura administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të goditur është zbatuar në përputhje me LPPA-në. Gjithashtu, gjykata vë në pah se vendimi i goditur është i hartuar sipas nenit 47, 48 dhe 134 të LPPA-së. Për më tepër, gjykata gjen se i Padituri është kompetent për zhvillimin e procedurës administrativ dhe nxjerrjen e vendimit të goditur.
19. Përveç kësaj, gjykata gjeti se i Padituri i ka konstatuar të gjitha faktet relevante lidhur me rastin, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë në kuptim të gjendjes faktike. Kjo gjykatë e vlerësoi të pabazuar pretendimin e Paditësit se ai nuk ka qenë investitor, por aksionari i tij si person fizik. Siç është sqaruar më lart, nga provat

e administruara Paditësi nuk ka arritur të provoj se investitor në objektin ku ka ndodhë aksidenti ka qenë vet R.M.

20. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Gjendja faktike e përshkruar më lart rregullohet në rend të parë me nenin 8 të LSSH-p-së, i cili në para. 4 ka rregulluar “*Punëdhënësi në cilësinë e investitorit, do të lidhë marrëveshje kontraktuale në formë të shkruar, me personat të cilët kryejnë veprimtari pune për të, përkatësisht me kontraktuesit dhe nënkontraktuesit, në të cilën marrëveshje përcaktohet përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, ndërsa me para. 5 të të njëjtit nen ka sanksionuar se “*Nëse nuk arrihet marrëveshje kontraktuale në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas këtij ligji, bie mbi investitorin*”. Siç vërehet nga kjo dispozitë, LSSH-p e trajton investitorin si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, përderisa ai nuk e bartë këtë përgjegjësi të kryerësi i punës përmes kontratës së shkruar.
21. Gjykata rikujton se kontrata e Paditësit me kryerësin e punëve NPSH Mehuka Com nuk e kishte paraparë se përgjegjësinë për sigurinë dhe shëndetin në punë e bartë kryerësi i punimeve, rrjedhimisht në bazë të nenit të cituar më lartë gjykata vjen në përfundim se Paditësi ligjërisht e kishte përgjegjësinë për sigurinë dhe shëndetin në punën në objektin e banimit kolektiv të cekur më lartë.
22. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj, se pavarësisht faktit se i lënduari nuk ka qenë i punësuar te Paditësi dhe faktit se ai ka qenë i angazhuar nga kryerësi i punimeve NPTH Mehuka Com, megjithatë ligjërisht Paditësi si investitor ka qenë i obliguar që të kujdeset për sigurinë dhe shëndetin në punë, gjegjësisht në rastin konkret të krijoj kushte pune për parandalimin e rreziqeve në punë, për zbatimin e masave parandaluese për shmangien e rrezikut nga rryma, të informoj të gjithë të punësuarit para fillimit të punës për rreziqet të cilave mund tu ekspozohen dhe masat parandaluese ndaj këtyre rreziqeve dhe të bëj vlerësimin e rreziqeve në punë me qëllim të parandalimit të tyre, sipas nenit 13 dhe neneve tjera pasuese të LSSH-p-së.
23. Në anën tjetër, sipas nenit 25 i LSSH-p-së i ka rregulluar sanksionet në të holla për shkeljet e ligjore, duke rregulluar se “*1. Personi fizik dhe personi juridik, që nuk i zbaton dispozitat e këtij ligji, në procedurë ligjore do të dënohet në të holla për secilën dispozitë të shkelur. 2. Për shkelje të dispozitave të nenit 5, 6, 9 dhe 10 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri në dhjetmijë*

(10.000) Euro. 3. Për shkeljet e dispozitave të nenit 7, 11, 12, 13, 15 dhe 17 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri tridhjetepesëmijë (35.000) Euro. 4. Për shkeljet e dispozitave të nenit 8 të këtij ligji, investitori, kontraktuesi, ose nënkontraktuesi do të dënohet në të holla në shumën prej pesmijë (5.000) deri tridhjetepesëmijë (35.000) Euro. 5. Për shkeljet e dispozitave të nenit 14 dhe 16 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri njëzetepesëmijë (25.000) Euro. 6. Për shkeljet e dispozitave të nenit 18 dhe 19 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro. 7. Për shkeljet e dispozitave të nenit 20, 22 dhe 23 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri njëzetmijë (20 000) Euro. 8. Për shkeljet e dispozitave të nenit 21 të këtij ligji, i punësuar do të dënohet në të holla në shumën prej njëqind (100) deri pesëmijë (5.000) Euro”. Nga këto dispozita kuptohet se LSShP ka paraparë sanksione prej minimumi 500€ deri në 35,000.00€ për shkeljet nga neni 13 para. 1 nënpara. 1.3 dhe 1.6, neni 18 para. 1 nënpara. 1.1 dhe neni 22 të ligjit, për cilët është gjetur përgjegjës Padiësi, të cilat sipas nenit 24 i shqipton i Padiësi.

24. Gjykata sqaron se meqenëse Padiësi është gjetur përgjegjës për shkelje të disa neneve nga LSShP, ndërsa i Padiësi e ka shqiptuar sanksionin afërt kufirit të lartësisë minimale të gjobës, atëherë gjykata vlerëson se gjoba është proporcionale me të gjitha shkeljet e konstatuara.
25. Prandaj, meqenëse i Padiësi ka qenë kompetent për të nxjerr vendimin e goditur, procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i Padiësi ka dhënë arsytim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, duke marrë parasysh se i Padiësi e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsytim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjor nga LPPA dhe LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Padiësit.
26. Gjykata e sheh të arsyeshme të sqaroj se i Padiësi në tre seancat e fundit të caktuara nga gjykata nuk ka qenë i pranishëm. Në seancën e datës 03.06.2024 përfaqësuesi me prokurë i Padiësit nuk kishte marrë pjesë për shkaqe shëndetësore, ndërsa gjykata duke e aprovuar kërkesën e tij për kthim në gjendjen e mëparshme i anuloi të gjitha veprimet

e ndërmarrë në atë seancë dhe e caktoi seancën për datën 10.09.2024. Gjithashtu në seancën e datës 10.09.2024 nuk mori pjesë, me arsyetimin se për atë datë paraprakisht ishte ftuar për një seancë tjetër në një gjykatë tjetër, ndërsa gjykata e aprovoi kërkesën e tij si të bazuar dhe e shtyu seancën për datën 10.12.2024. Në kuptim të nenit 437 para. 2 të LPK-së, shtatë ditë para mbajtjes së seancës, konkretisht më 02.12.2024, gjykata e bëri verifikimin se a janë plotësuar kushtet që të mbahet seanca dhe konstatoi se palët ishin ftuar me rregull, nuk kishte pasur kërkesa për shtyrje të seancës e as nuk kishte pasur pengesa tjera ligjore.

27. Gjithsesi, edhe për seancë e datës 10.12.2024 përfaqësuesi me prokurë i Paditësit kishte paraqitur kërkesë për shtyrjen me pretendimin se për ditën e njëjtë nga ora 10:00 është ftuar nga një gjykatë tjetër për një çështje penale dhe se ftesën për atë seancë e ka pranuar para ftesës së kësaj gjykate. Gjykata në rend të parë gjeti se përfaqësuesi me prokurë i Paditësit ftesën për seancën e caktuar nga kjo gjykatë e kishte pranuar më 16.09.2024, ndërsa ftesën për seancën penale të caktuar e ka pranuar pas datës 25.10.2024, meqenëse ftesa për seancën penale ishte hartuar më 25.10.2024, që nënkupton se përfaqësuesi me prokurë i Paditësit ftesën e kësaj gjykate e ka pranuar më tepër se një muaj më herët se sa ftesën për seancën penale. Gjithashtu, gjykata gjeti se përfaqësuesi me prokurë më 06.12.2024 përmes postës në formë rekomande e kishte dorëzuar kërkesën për shtyrjen e seancës, ndërsa gjykatës i ka arritur më 12.12.2024, që nënkupton pas mbajtjes së seancës. Pavarësisht nenit 127 para. 2 të LPK-së, kjo gjykatë vlerëson se kërkesa e përfaqësuesit me prokurë të Paditësit nuk është paraqitur me kohë, meqenëse është parashtruar pas afatit shtatë ditor kur gjykata i ka verifikuar kushtet për mbajtjen e seancës dhe se ai ka qenë i njoftuar për të dy seancat që nga muaji nëntor i vitit 2024, pra rreth një muaj para seancës, dhe vet ka zgjedhur që pak ditë para seancës të paraqes kërkesë për shtyrjen e saj, ndonëse nuk ka pasur asnjë pengesë që herët ta bëjë atë. Gjithashtu, gjykata rikujton se mundësia juridike e paraqitjes së kërkesa për shtyrjen e seancës për shkak të ftesës për një seancë tjetër për të njëjtin orar veç se ishte konsumuar sipas nenit 438 para. 2 i LPK-së, sipas të cilës pala mund ta propozojë shtyrjen e seancës vetëm një herë nga shkak i njëjtë. Për këto arsye gjykata e pati juridikisht të pamundshme të aprovoj kërkesën për shtyrjen e seancës, të paraqitur nga përfaqësuesi me prokurë të Paditësit

28. Nga arsyet e lartcekura gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesëpadia e Paditësit është e pabazuar, rrjedhimisht bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të

Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.304/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.